

Performanca e Buxhetit 2018



NË KËTË RAPORT

Periudha raportimit: Janar - Dhjetor 2018

Statusi raportit: Raporti bazohet në të dhëna të konsoliduara të zbatimit të buxhetit për bashkinë Klos gjatë vitit 2018 dhe është miratuar në Këshillin Bashkiak

Përmbledhje mbi situatën financiare, të ardhurat, shpenzimet sipas programeve si edhe rezultatet kryesore të ekzekutimit të buxhetit për vitin 2018

Ky raport është përparitur nga Bashkia Klos me asistencën e Projektit "Bashki të Forta". Për më shumë informacion në lidhje me të kontaktoni me Zj.Fitnete Krosi në adresën

TË DHËNA TË PËRGJITHSHME



Popullsia: Censuri (2011) 16.618 banorë
 Rregjistri Civil 20.281 banorë

Siperfaqja: 357,48 km²

Dendësia: Censuri (2011) 46 banorë/km²
 Rregjistri Civil 58,24 banorë/km²

Nëndarjet Administrative: 4

(1) Klos (2) Xibër (3) Suç (4) Gurrë

Rezultatet në zgjedhjet vendore të vitit 2015 si më poshtë:



Shpërndarja e anëtarëve:

3	Anëtarë
2	Anëtarë
2	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë
1	Anëtarë

EKZEKUTIVI Numri i përgjithshëm i zgjedhësve të regjistruar në Bashkinë Klos për zgjedhjet vendore të vitit 2015 ishte 15.326 persona. Pjesëmarrja e votuesve në zgjedhjet e fundit lokale ishte 61%. Këshilli bashkiak përbëhet nga 21 anëtarë të grupuar midis partive politike LSI, PD, PS, PDIU, PR.

Kryetari i Bashkisë Klos është Z.Basir ÇUPA.

EKONOMIA Degët kryesore të ekonomisë janë bujqësia, ku klima e favorshme lejon kultivimin e të gjitha bimëve e drufrutorëve, blegtoria dhe shërbimet. Klosi është i pasur me burime të shumta natyrore, tokësore dhe nëntokësore. Pyjet dhe kullotat komunale zënë një sipërfaqe të konsiderueshme, ku përveç lëndës drusore, ka edhe mjaft bimë mjekësore.

Një tjetër burim kryesor të ardhurash për banorët e këtij rajoni përbën edhe turizmi malor dhe historik, si dhe indus-

SITUATA FINANCIARE

Bashkia ka tre objektiva kryesorë të saj:

- ⇒ Të sigurojë zhvillim ekonomik të qëndrueshëm dhe përdorim me ndërgjegje të burimeve natyrore
- ⇒ Përmirësimin e kushteve të vendbanimeve ekzistuese për të stopuar migrimin e popullatës
- ⇒ Ruajtjen e burimeve natyrore dhe trashëgimisë kulturore me anë të promovimit të tyre si burim i turizmit

Bashkia Klos ka menaxhuar në mënyrë të kujdesshme financat e saj duke realizuar shpenzimin e të ardhurave të saj në nivelin 100%;

Gjithashtu Bashkia Klos në sajë të mirë administrimit fiskal, ka rritur peshën e të ardhurave nga burimet e veta ndaj totalit të burimeve financiare, duke mbuluar rreth 11% të totalit;

2018 Vs 2017

Treguesit

Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve
 Norma e të ardhurave nga taxat dhe tarifa vendore ndaj totalit të të ardhurave
 Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifa vendore ndaj totalit të të ardhurave




Burimi i informacionit
 "ITF 2018 - Monitorimi i Financave"

Fakt 2016, 2017, 2018

Treguesit

Norma e shpenzimeve në politikat sociale ndaj totalit të shpenzimeve
 Norma e të ardhurave nga taxat dhe tarifa vendore ndaj totalit të të ardhurave
 Norma e të ardhurave nga taksat dhe tarifa vendore ndaj totalit të të ardhurave
 Norma e totalit të shpenzimeve ndaj totalit të të ardhurave



Burimi i informacionit
 "ITF 2018 - Monitorimi i Financave"

BUXHETI 2018

Burimet e financimit (Buxheti i rishikuar) 2018

- ⇒ Transferta e pakushtëzuar
- ⇒ Transferta e kushtëzuar
- ⇒ Transferta specifike
- ⇒ Të ardhurat nga taksat dhe tarifat
- ⇒ Të ardhura të trashëguara nga viti 2017

Buxheti për vitin 2018 = 641.918
mijë lekë




Shërbimet kryesore të ofruara dhe financuara nga bashkia janë:

- ⇒ Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rru-gëve; ndërtesat publike; shkolla; parqet dhe zonat rekreative, qen-drat e kujdesit shëndetësor parësor; ndërtesat e administratës lokale etj.
- ⇒ Transporti publik
- ⇒ Ujë i pijshëm dhe kanalizime
- ⇒ Menaxhimi i mbeturinave komunale
- ⇒ Menaxhimi i sistemit të ujitjes dhe kullimit të mesëm dhe terciar
- ⇒ Fidanishte, çerdhe dhe edukim pa-rashkollor
- ⇒ Mirëmbajtja e institucioneve të arsimit parauniversitar
- ⇒ Menaxhimi i kullotave dhe pyjeve komunale
- ⇒ Mbrojtja nga zjarri dhe shpëtimi
- ⇒ Shërbimet sociale
- ⇒ Menaxhimi i varrezave publike
- ⇒ Menaxhimi i kadastrës të bu-

TE ARDHURAT 2018

Ecuria e të ardhurave nga taksat dhe tarifat, Fakt, Plan 2018




SHPENZIMET

Bashkia Klos i kushton vëmendje gjithnjë e më shumë në rritje shërbimeve sociale dhe infrastrukturës. Programet buxhetore më të financuara gjatë vitit 2018, që përbënin rreth 95% të buxhetit, janë:

- A. Përkujdesi Social
- B. Planifikim Menaxhim dhe Administrim
- C. Infrastruktura rrugore (urbane dhe rurale) dhe transportin publik
- D. Arsimit Baze dhe parashkollor
- E. Ujitja dhe Kullimi
- F. Menaxhimi i Ujit të pijshëm dhe Kanalizime

% ndaj totalit të Buxhetit, 2018



Shpenzimet sipas Programeve Buxhetore, në Loka



Burimi i Informacionit:
* Raporti i Monitorimit 2018 - Bashkia e Klosit

SHPENZIMET

Të ndara sipas aktivitetit ekonomik, shpenzimet kapitale përbëjnë 29% të totalit të shpenzimeve kurse ato operative 71%.

Në grafik paraqitet % e realizimit ndaj planifikimit, ndërsa tabela me poshtë liston

Shpenzimet sipas Klasifikimeve Ekonomike në Lekë



Burimi i Informacionit
 "Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Vlorës"


Projektat e Investimeve në Lekë



Burimi i Informacionit
 "Raporti i Menaxhimit 2018 - Bashkia e Vlorës"

TREGUESIT E PERFORMANCES

Rezultatet vjetore të treguesve të performancës buxhetore



Bashkia ka rritur performancën e përdorimit të fondeve buxhetore. Kjo rritje ka ardhur edhe në sajë të rritjes së transparencës së vendimarrjes bashkiake.

Të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak kanë qenë të hapura dhe pjesa më e madhe e vendimeve që detyrojnë konsultimin me publikun janë diskutuar paraprakisht me banorët.

Disa arritje të rëndësishme të përmirësimit të shërbimeve ofruar komunitetit vendor falë rritjes jo vetëm të burimeve financiare, por edhe të kapaciteteve njerëzore të bashkisë janë renditur më poshtë, tregues performance sipas programeve.


PROGRAMI

PLANIFIKIMI MENAXHIMI DHE ADMINISTRIMI

Objektivi i programit -

Përmirësimi i Burimeve
Njerëzore të Bashkisë

*Realizimi i shpenzimeve : 93%
e planifikimit, 78.168 mijë lekë*



TREGUES PERFORMANCE:

Administrata e bashkisë ka 84 punonjës nga të cilët rreth 50% e punonjësve kanë marrë statusin e nëpunësit civil. Kjo shifër synon të jetë e tillë për tre vitet e ardhshme duke siguruar qëndrueshmëri në administratë.

- TP 1.** Rritja e qëndrueshmërisë së administratës civile
- TP 2.** Përmirësimi i punës së stafit të bashkisë
- TP 3.** Rritja e kapaciteteve / burimeve njerëzore të bashkisë

PROGRAMI

MBROJTJA NGA ZJARRI DHE MBROJTJA CIVILE—EMERGJENCAT

Objektivi i programit -

Përmirësimi i shërbimeve dhe infrastrukturës së shuarjes së zjarrit dhe




TREGUES PERFORMANCE:

Ky është një funksion i ri i bashkisë. Për këtë arsye bashkia duhet së pari të ngrejë shërbimin tërësisht. Për këtë në planet e bashkisë është realizimi i standardeve ligjore, si sigurimi i një makine zjarrëfikëse dhe krijimi i një strukture

Realizimi i shpenzimeve emergjencat: 57% e planifikimit, 13.298 mijë lekë dhe

PROGRAMI

MENAXHIMI SISTEMIT TE VADITJES DHE KULLIMIT



Objektiva- Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të vaditjes dhe kullimit

Bashkia ka punuar për të përmirësuar situatën për familjet fermere dhe biznesin bujqësor duke përmirësuar infrastrukturën e vaditjes dhe kullimit

TREGUES PERFORMANCE

Bashkia ka trashëguar një sistem vaditës dhe kullues prej 74 km linear kanale kulluese dhe 130 km linear kanale vaditëse të cilat mbulojnë me shërbim një sipërfaqe bujqësore prej 885 ha tokë.

Bashkia ka si synim të rrisë sipërfaqen e mbuluar me sistem vaditës dhe kullues. Gjatë vitit 2018 bashkia pastroi rreth 3 km linear kanal kulluese.

Performanca e bashkisë gjatë një viti më parë ishte më e mirë, por duke pasur parasysh se ky sistem kishte më shumë sesa një dekadë pa u bërë funksional, synimi ynë është që pak nga pak çdo vit të arrihet të pastrohet një pjesë e sistemit.

Përmirësime më të mëdha priten në vitet në vijim si rrjedhojë e investimeve të rëndësishme të bëra në sistem të cilat janë rritur më shumë sesa 53% kundrejt vitit 2017.

TP 1. Përmirësimi i shërbimit

-Rritja e sipërfaqes bujqësore e mbuluar me ujitje (trendi në %)

-Rritja e sipërfaqes bujqësore së mbuluar me kullim (trendi në %)

TP 2. Përmirësimi i sistemit

-Përmirësimi i rrjetit të kullimit të pastruar apo shtuar (në % kundrejt rrjetit total)

-Përmirësimi i rrjetit vaditjes të pastruar apo shtuar (% kundrejt rrjetit total)


**Realizimi i shpenzimeve:
68% e planifikimit, 18.280
mijë lekë dhe përbën 4% të**

PROGRAMI

SHËRBIMI I UJIT TË PIJSHËM DHE KANALIZIMET

Objektivi i programit

Përmirësimi i ofrimit të shërbimit të ujit të pijshëm
Përmirësimi i menaxhimit të ujërave të përdorura (zeza dhe bardha) / shërbimeve sanitare



Tregues Performance

Bashkia mbulon më shumë se 50% të popullatës me shërbimin e ujit të pijshëm dhe mbi 20% të popullatës me kanalizime sanitare. Ofrimi i shërbimit bëhet nga një ekip prej 29 punonjësish të bashkisë.

Gjatë vitit 2018 bashkia ka investuar rreth 1.7 milionë lekë në sistemin e kanalizimeve sanitare dhe 2.9 milionë lekë për përmirësimin e sistemit të ujit të pijshëm për popullatën përkatësisht në dy projekte: ujësjellësi Plan i Bardhë në Klos Katund dhe Ujësjellësi i Zall Pleshës.

Shërbimi arrin të mbulojë rreth 50% të koston nga tarifat që mblidhen.

TP1. % e popullatës mbuluar me ujë të pijshëm

TP 2. % e popullatës mbuluar me kanalizime sanitare

TP 3. % e koston së shërbimit të ujit të pijshëm e mbuluar nga tarifa

TP 4. % e koston së shërbimit të kanalizimeve e mbuluar nga tarifa

TP 5. Kohëzgjatja e u furnizimit me ujë të pijshëm (orë në ditë)

PROGRAMI

RRJETI RRUGOR

Objektivi i programit

Bashkia siguron akses rrugor të të gjitha njësive administrative të saj tek

Realizimi i shpenzimeve : rreth 98% e planifikimit, 64.102 mijë

Tregues Performance

Bashkia ka një numër punonjësish prej 39 veta të cilët merren me mirëmbajtjen e rrjetit rrugor të bashkisë. Gjatë vitit 2018 bashkia ka mirëmbajtur rreth 32 km liner rrugë.

TP1. Zgjerimi i rrjetit rrugor:

- Rrugë rurale
- Rrugë urbane

TP2. Eficienca e alokimit të buxhetit për përmirësimin e infrastrukturës rrugore:



PROGRAMI

ARSIMI BAZË

Objektivi i programit

Rritja e frekuentimit të sistemit parashkollor

Realizimi i shpenzimeve : rreth 86% e planifikimit, 45.503 mijë

Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor

Bashkia ka rreth 601 fëmijë të moshës nga 3 deri në 6 vjec që marrin shërbim në kopshte dhe klasat e parashkollorit në sistemin publik.

Në klasat e parashkollorit mesatarisht shërben një edukator për 15 fëmijë dhe kapaciteti maksimal i akomodimit për kopshtet me fjetore është rreth 40 shtretër për



TREGUES PERFORMANCE

TP1. Numri mesatar i femijeve per punonjes mesimore

TP2. Numri mesatar i nxënësve në një klasë

PROGRAMI

SHERBIMI SOCIAL

Objektivi i programit

Mbështetje më e mirë e personave me aftësi të kufizuar

Realizimi i shpenzimeve : rreth 95% e planifikimit, 211.097

TREGUES PERFORMANCE

Bashkia ka arritur objektivin si rrjedhojë e përmirësimit të të gjithë treguesve të performancës së këtij programi buxhetor

Gjatë vitit 2018 bashkia ka mbështetur rreth 754 persona me aftësi të kufizuar, nga të cilët 3 personave të kësaj kategorie u është ofruar punë dhe kanë dalë nga asistenca e ofruar në vite.

Bashkia ka përmirësuar punën në shërbimin kundrejt kësaj kategorie personash duke disbursuar asistencën monetare brenda 2 ditëve.

